



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Prishtinë, më 11 maj 2012  
Nr. ref.: RK 254/12

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI17/12**

Parashtrues

**Elez Hajdaraj**

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Kosovës  
nr. 12/59, të datës 1 shkurt 2012**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Cukalovic, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Elez Hajdaraj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) me banim në fshatin Shushicë, Komuna e Istogut.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik, vlerësimi i kushtetutshmërisë i të cilit kërkohet nga Gjykata Kushtetuese, është Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr. 12/59, i datës 1 shkurt 2012, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më datën 23 shkurt 2012.

## **Objekti i çështjes**

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), më 28 shkurt 2012, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Kosovës nr. 12/59, të datës 1 shkurt 2012, në bazë të cilit parashtruesi i kërkesës është shkarkuar nga pozita e anëtarit të Bordit të Kompanisë Rajonale Ujësjellësi "Hidrodrini" SH.A. (në tekstin e mëtejme: KUR), me seli në Pejë.

## **Baza juridike**

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 22 dhe 27 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, dhe rregullat 54, 55 dhe 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 28 shkurt 2012, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë dhe e njëjta u regjistrua në Gjykatë më nr. KI 17/12.
6. Më 29 shkurt, me Vendimin G.J.R.KI 17/12, Kryetari i Gjykatës e caktoi Gjyqtar raportues gjyqtarin Altay Suroy, ndërsa me Vendimin KSH 17/12 Kolegjin shqyrtues në përbërje Ivan Cukalovic (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami në cilësi të anëtarëve të Kolegjit.
7. Më 5 mars 2012, Gjykata Kushtetuese kishte njoftuar Agjencinë kundër Korrupsionit lidhur me kërkesën e parashtruar.
8. Më 5 mars 2012, Gjykata kishte njoftuar Qeverinë e Republikës së Kosovës lidhur me kërkesën e parashtruar.
9. Më 16 mars 2012, Agjencia kundër Korrupsionit kishte dërguar në Gjykatë përgjigje lidhur me kërkesën, në të cilën thekson se "z. Hajdaraj ka qenë i informuar me kohë lidhur me dyshimin për ekzistimin e konfliktit të interesit pasi që i njëjti ka ushtruar funksionin e anëtarit të Bordit të Drejtorëve dhe si 'Zyrtar përgjegjës i sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime", situatë kjo që është në kundërshtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.02-L-133 dhe Ligjin për Ndërmarrjet Publike Nr.03-L-087. Ndërsa ai nuk ka ndërmarrë asnjë veprim që brenda afatit ligjor të zgjidhë këtë situatë, andaj kjo agjenci, në përputhje

me kompetencat ligjore, i ka propozuar Qeverisë shkarkimin e tij nga funksioni i anëtarit të Bordit në Ndërmarrjen publike KUR "Hidrodrini" SH.A.-Pejë.

10. Më 20 mars, Qeveria e Republikës së Kosovës kishte dërguar në Gjykatë përgjigje në njoftim në të cilën shpjegon se procedura e shkarkimit të z. Elez Hajdaraj nga pozita e anëtarit të Bordit të N.P. KUR "Hidrodrini" ishte iniciuar nga Agjencia kundër Korrupsionit, dhe se propozimin e kësaj agjencie Qeveria e kishte miratuar si të bazuar, andaj, konform gjendjes së konstatuar nga kjo Agjenci për konfliktin e interesit të cilin z. Hajdaraj nuk e kishte mënjanuar, edhe është marrë vendimi për shkarkim.
11. Më 9 maj 20012, Kolegji shqyrtues, në përbërje si në paragrafin 6 të këtij aktvendimi, i propozoi njëzëri Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhje e fakteve**

12. Më 16 tetor 2008, Zyra e Sekretarit të Përhershëm e Qeverisë së Kosovës ka publikuar në mediumet publike në Kosovë konkursin për Drejtor të Bordeve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore, e në pikën 11 edhe për KUR "Hidrodrini" SH.A.-Pejë.
13. Më 24 dhjetor 2008, Qeveria e Republikës së Kosovës mori Vendimin Nr. 12/48, me të cilin në Bordin e Ndërmarrjes Publike KUR "Hidrodrini" SHA-Pejë emëroi këta kandidatë: 1) z. Shkëlzen Hyseni, kryesues; 2) z. Rexhë Abazi; 3) z. Elez Hajdaraj (parashtruesin e kërkesës në GJ.K.) dhe 4) z. Kolë Berisha.
14. Më 23 prill 2009, Qeveria e Republikës së Kosovës mori Vendimin Nr. 10/61 për ndryshimin e Vendimit Nr. 12 /48, të datës 24 dhjetor 2008, për emërimin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të KUR "Hidrodrini" SH.A.-Pejë, me të cilin anëtarin e bordit, z. Kolë Berisha, e zëvendëson me anëtarin e ri z. Gjelosh Gojani, ndërsa edhe në bazë të këtij vendimi i z. Elez Hajdaraj mbetet i emëruar në pozitën e anëtarit të Bordit të kësaj Ndërmarrje Publike.
15. Më 4 nëntor 2009, parashtruesi i kërkesës e paditë KUR "Hidrodrini" në Gjykatën Komunale në Istog, për kompensim të ardhurave të realizuara në bazë të punës si anëtar i Bordit. Gjykata Komunale në Istog këtë padi e regjistroi më shifrën C. Nr. 314/09.
16. Më 28 dhjetor 2009, pala e paditur, KUR "Hidrodrini", përgjigjet në padinë e parashtruesit të kërkesës C.Nr 314/09, duke e kundërshtuar në tërësi padinë si të pabazë. Sipas palës së paditur, parashtruesi i kërkesës në këtë kompani, në bazë të kontratës për punësim në mes të parashtruesit të kërkesës dhe palës së paditur nr. 27 të datës 19 shkurt 2009, z. Elez Hajdaraj është emëruar në pozitën "Përgjegjës i sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizim" dhe sipas tyre një person nuk mund të merr të ardhura të dyfishta nga e njëjta ndërmarrje.

17. Më 24 shtator 2010, Gjykata Komunale në Istog, në bazë të Aktgjykimit C. nr. 314/09, e aprovon padinë e parashtruesit të kërkesës dhe në këtë mënyrë pala e paditur është e obliguar që t'ia kompensojë, në afat prej 15 ditësh, shumën në vlerë prej 5.400,00 Euro (pesë mijë e katërqind) të realizuara në bazë të punës si anëtar i Bordit.
18. Nga shkresat e bashkangjitura me kërkesën nuk mund të konstatohet fakti nëse ndaj këtij aktgjykimi është ushtruar ndonjë ankesë.
19. Më 17 maj 2011, Agjencia kundër Korrupsionit e kishte njoftuar z. Elez Hajdaraj lidhur me inicimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit lidhur me funksionin e parashtruesit të kërkesës si anëtar i Bordit të drejtorëve krahas pozitës si punëtor i rregullt në kompaninë KUR "Hidrodrini".
20. Më 20 korrik 2011, Agjencia kundër Korrupsionit e kishte paralajmëruar sërish parashtruesin e kërkesës për gjendjen e konfliktit të interesit, dhe kishte kërkuar nga parashtruesi i kërkesës që në afat prej 30 ditësh të ndërmarrë të gjithë hapat për shmangien e konfliktit të interesit.
21. Më 1 gusht 2011, parashtruesi i kërkesës i është përgjigjur Agjencisë kundër Korrupsionit, duke theksuar se persona për qëllime të caktuara brenda ndërmarrjes i kishin falsifikuar shkresat në të cilat parashtruesi emërohej si "Zyrtar", dhe se ai në pozitën e anëtarit të Bordit të Drejtorëve ishte zgjedhur në bazë të konkursit të rregullt.
22. Më 6 tetor 2011, Agjencia kundër Korrupsionit, me shkresën nr. AKK-DP-03/11, i propozon Qeverisë së Kosovës **shkarkimin** e z. Elez Hajdaraj nga pozita e anëtarit të Bordit të KUR "Hidrodrini" SH.A., në Pejë, pasi që është konstatuar gjendja e konfliktit të interesit të tij me Ndërmarrjen publike ku është anëtarë i Bordit të drejtorëve.
23. Më 1 shkurt 2012, Qeveria e Kosovës në bazë të vendimit 12/59 e aprovon kërkesën e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe vendos që parashtruesin e kërkesës, z. Elez Hajdaraj, të shkarkojë nga pozita e anëtarit të Bordit të drejtorëve në KUR "Hidrodrini" SH.A. -Pejë, duke dhënë arsyetimin sikur në paragrafin 12 të këtij raporti.

### **Shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara kushtetuese**

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 12/59, të datës 1 shkurt 2012, i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si në vijim: neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Dinjiteti i Njeriut) dhe neni 26 (E Drejta e Integritetit Personal), ndërsa nga Gjykata Kushtetuese ka kërkuar prishjen e Vendimit të Qeverisë së Kosovës nr. 12/59, të datës 01.02.2012, dhe gjithashtu ka kërkuar që Gjykata Kushtetuese ta "detyrojë" Agjencinë kundër Korrupsionit që atij t'i kërkojë "falje

publike” nëpërmes mjeteve të informimit publik për shkak të shkeljes së dinjitetit të tij.

## **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

Për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës të Gjykatës.

25. Lidhur me këtë i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, ku përcaktohet:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

26. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 par. 1, pika(a) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese ku qartë përcaktohet se Gjykata mund të shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

“Janë shterur të gjitha mjetet efektive juridike të përcaktuar me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar”.

27. Për të konstatuar faktin nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriterin e pranueshmërisë së shterjes së mjeteve juridike para se t’i drejtohej Gjykatës Kushtetuese, Gjykata merr parasysh dispozitat ligjore që rregullojnë këtë materie juridike dhe veçanërisht dispozitat e: Ligjit për Administratën shtetërore të Republikës së Kosovës (Ligji nr 03/L-189), Ligjit për Procedurën Administrative (Ligji nr. 02/L-28), Ligjit Për Konfliktet Administrative (Ligji nr. 03. L/202) dhe Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, dhe atë:

## **Ligji për Procedurën Administrative**

Neni 1.

1.1. Dispozitat e këtij Ligji zbatohen nga të gjitha organet e administratës publike gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre nëpërmjet akteve individuale dhe kolektive.

## **Ligji për Administratën Shtetërore**

**Neni 2**

1.1 Autoritetet e larta të administratës shtetërore – Qeverinë si tërësi, Kryeministrin, Zëvendës Kryeministrat dhe ministrat.

1.2. Organet e larta të administratës shtetërore - Zyra e Kryeministrit dhe Ministrinë janë organet e larta të administratës shtetërore përmes të cilave Autoritetet e Larta të Administratës Shtetërore ushtrojnë kompetencat e tyre qeveritare dhe administrative.

## **Neni 4 - Punët e Administratës Shtetërore**

### **1. Punët e administratës shtetërore janë:**

- 1.6 Vendosja në procedurën administrative mbi të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve dhe personave juridik.

## **Ligji Për Konfliktet Administrative**

### **Neni 3 -Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
  - 1.1. **Organ** - organet e administratës publike, organet e qeverisjes qendrore dhe organet e tjera në varësi të tyre, organet e vetëqeverisjes lokale dhe organet në varësi të tyre, kur në ushtrimin e autorizimeve publike vendosin në çështjet administrative.
  - 1.2. **Akt administrativ** - çdo vendim të organit të paraparë në nën-paragrafin 1.1. të këtij paragrafi, i cili merret në fund të një procedure administrative në ushtrimin e autorizimeve publike dhe që prek, në mënyrë të favorshme ose jo të favorshme të drejtat e njohura ligjrisht, liritë ose interesat e personave fizikë ose juridikë përkatësisht palës tjetër në vendosjen e çështjes administrative.

### **Neni 11**

Konflikti administrativ, sipas aktpadisë, zgjidhet nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.

### **Neni 13**

1. Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë.
  2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar.
28. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'ua ofrojë autoriteteve në fjalë, përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës do të sigurojë mjet efikas ligjor për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni v. France nr. 25803/94, Vendim i 28 korrikut 1999).
29. Sa i përket çështjeve të ngritura lidhur me procedurën e zhvilluar nga Agjencia kundër Korrupsionit dhe dyshimit të ngritur lidhur me aplikimin e drejtë të Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (Ligji nr. 03 L -155) dhe të Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Ligji 03L-087), Gjykata thekson se Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e verifikimit të fakteve dhe me këtë rast dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është

juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i sajë (i Gjykatës Kushtuese) është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (shih, *mutatis mutandis*, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).

30. Për më tepër, në nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], pika 3, të Kushtetutës është qartazi e paraparë që: **"Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit."**
- 31 Në këto rrethana, kërkesa është **e papranueshme**, sepse parashtuesi i kërkesës **nuk i ka shteruar** të gjitha mjetet juridike efektive para se t'i drejtohej Gjykatës **Kushtuese** dhe rrjedhimisht nuk i ka plotësuar kriteret për pranueshmërinë e kërkesës.


### PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtuese dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtuese në seancën e 9 majit 2012, njëzëri:

### VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtuese



Prof. dr. Enver Hasani